



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

---

## **GJEOGRAFIA E KRIMIT (2013-2017)**

PËRFSHIRJA E PERSONAVE NË VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE  
TË MEKANIZMIT PËRCJELLËS NDËRINSTITUCIONAL

Përgatitur nga koordinatori nacional për  
Mekanizmin Përcjellës Ndërinstitucional (MPN)

Nëntor 2018, Prishtinë

## HYRJE

Qëllimi parësor i këtij raporti është njohja e realizuar përmes hulumtimit mbi përhapjen e kriminalitetit (*vetëm për veprat penale karakteristike*), në Republikën e Kosovës në përgjithësi dhe në shtatë (7) rajonet në veçanti, sipas kriterit të kompetencës territoriale të Prokurorive themelore.

Të gjeturat dhe rezultatet e këtij raporti do të shërbejnë për hartimin e politikave kriminale në parandalimin dhe luftimin e veprave penale karakteristike (Armët, Drogat, Kontrabandimi me migrant, Krimi organizuar, Korrupsioni, Shpërlarja e parasë, Trafikimi me njerëz, Krimet ekonomike dhe Nxitja urrejtjes).

Objekt të këtij raporti janë personat e dyshuar, të akuzuar dhe të dënuar për veprat penale karakteristike të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional, të kategorizuara sipas prokurorive themelore që pasqyrojnë shtatë (7) rajone (Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Peja, Gjakova, Gjilani dhe Ferizaji);

Të dhënat për numrin e banorëve, të marrura nga raporti vjetor 2017, i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, kanë shërbyer për analizën krahasimore, të nevojshme për realizimin e qëllimit parësor të këtij raporti.

Raporti i gjeografisë së krimit është i ndarë në katër pjesë. Në pjesën e parë janë pasqyruar të dhënat lidhur me kategorizimin e banorëve resident në të përgjegjshëm penalisht dhe të papërgjegjshëm penalisht (*përgjegjësia penale*).

Pjesa e dytë e raportit përmban të dhëna krahasimore dhe analitike për personat e përfshirë në rastet penale (*Kallëzimet penale dhe Informatat PPN*), për veprat penale karakteristike, panoramën e kryesve sipas viteve (2013-2017) dhe profilin e të dyshuarve.

Në pjesën e tretë janë pasqyruar të dhënat sasiore dhe analitike për personat e akuzuar nga prokuroritë respektive, profile i të akuzuarve si dhe panorama e akuzimeve sipas viteve (dimensioni kohor).

Pjesa e katërt e adreson çështjen e vendimeve gjyqësore, duke përfshirë personat e shpallur fajtor nga gjykatat e shkallës së parë, për veprat penale karakteristike, profilin e të dënuarve si dhe dënimet sipas viteve.

Pas këtyre katër pjesëve, janë dhënë konstatimet dhe rekomandimet konkretet për Këshillin Prokurorial të Kosovës, që përmes hartimit të politikave kriminale të realizoj synimin për rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve për veprat penale karakteristike.

## PËRMBAJTJA

1	Demografia nga këndvështrimin penal.....	4
1.1	Përgjegjshmëria penale.....	4
1.2	Panorama e kompetencës territoriale .....	5
2	Ndjekja penale.....	6
2.1	Të dhëna për personat e përfshirë në rastet penale.....	6
2.2	Të dhëna për veprat penale.....	7
2.3	Panorama e ndjekjes penale.....	8
2.4	Ndjekja penale në dimensionin kohor.....	9
2.5	Profili i të dyshuarve.....	10
3	Akuzimi.....	11
3.1	Të dhëna për personat e akuzuar.....	11
3.2	Profili i të akuzuarëve.....	12
3.3	Panorama e akuzimeve.....	13
3.4	Akuzimi në dimensionin kohor.....	14
4	Dënimi.....	15
4.1	Të dhëna për vendimet gjyqësore.....	15
4.2	Të dhëna për veprat penale.....	16
4.3	Profili i të dënuarëve.....	17
4.4	Dënimet në dimensionin kohor.....	18
5	Konstatime.....	19
6	Rekomandime.....	22

## 1. DEMOGRAFIA NË KËNDVËSHTRIMIN PENAL

### 1.1 PËRGJEGJSHMËRIA PENALE

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 dhe vlerësimit të popullsisë<sup>1</sup> në komunitet në të cilat nuk është bërë regjistrimi, rezultojnë se në Republikën e Kosovës jetojnë: 1.780.021 banorëve resident. Sipas kriterit të përgjegjshëm penale (*moshës*), rezultojnë se 1.281.204 banorë janë penalisht të përgjegjshëm (të moshës 14 vjeç e mbi), ndërsa 498.817 banorë janë penalisht të papërgjegjshëm<sup>2</sup> (të moshës nën 14 vjeç), (shih figurën 1).

#	PROKURORIA/ RAJONI	Numri i banorëve resident	Penalisht të përgjegjshëm (14+ vjeç)	Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)
1	PRISHTINË	470.583	338.804	131.779
2	PRIZREN	277.007	199.915	77.092
3	PEJË	220.338	160.986	59.352
4	GJILAN	188.188	138.348	49.840
5	MITROVICË	232.833	166.577	66.256
6	FERIZAJ	185.695	131.418	54.277
7	GJAKOVË	205.377	145.156	60.221
	Gjithsej:	1.780.021	1.281.204	498.817

Figura 1

Sipas kriterit rajonal, rajoni Prishtinës rezultojnë të ketë numrin më të lartë të banorëve, të përgjegjshëm penalisht (14+ vjeç), me 26.44%, ndërsa rajoni i Ferizajit numrin më të ulët të banorëve të përgjegjshëm penalisht, me 10.26%. Në përlogaritjen sipas numrit më të lartë të banorëve penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç), rezultojnë të ketë rajoni i Prishtinës, me 26.42%, ndërsa rajoni Gjilanit numrin më të ulët të banorëve penalisht të papërgjegjshëm, me 9.99% (shih figurën 2).




Figura 2

<sup>1</sup> Qeveria e Kosovës, (2017), "Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës", ASK, Prishtinë. Me termin "numri i popullsisë" i referohemi procesit të regjistrimit të vitit 2011 si dhe aspektin e vlerësimit.

<sup>2</sup> "Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet", paragrafi 3, nga neni 17 (përgjegjësia penale), të Kodit Penal të Kosovës.

## 1.2 PANORAMA E KOMPETENCËS TERRITORIALE

Meqenëse, Prokuroritë Themelore kanë kompetencë territoriale në komunat përkatëse, përmes tabelës, si më poshtë, pasqyrojmë komunat përkatëse që bëjnë pjesë në kuadër të rajoneve, duke përfshirë edhe të dhënat statistikore për numrin e banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht si dhe numrin e banorëve penalisht të papërgjegjshëm (shih figurën 3).

RAJONET	KOMUNA	Numri banorëve resident	Banorë, penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç)	Banorë, penalisht të papërgjegjshëm (-14vjeç)
<b>PRISHTINA: 470.583 banorë</b> (338.804, me14+vjeç dhe 131.7792 nën 14 vjeç)	1 Prishtinë	198897	147494	51403
	2 Podujevë	88499	61691	26808
	3 Glllogoc	58531	41236	17295
	4 Lipjan	57605	40410	17195
	5 Fushë Kosovë	34827	24831	9996
	6 Obiliq	21549	15130	6419
	7 Graçanicë	10675	8012	2663
<b>PRIZRENI: 277.007 banorë</b> (199.915, me14+vjeç dhe 77.092 nën 14 vjeç)	1 Prizren	177781	128582	49199
	2 Suharekë	59722	42313	17409
	3 Dragash	33997	25339	8658
	4 Mamushë	5507	3681	1826
<b>MITROVICA: 232.833 banorë</b> (166.577 me14+vjeç dhe 66.256 nën 14 vjeç)	1 Mitrovica jugore	71909	51558	20351
	2 Leposaviq	13773	9922	3851
	3 Zubin potok	6616	4766	1850
	4 Zveçan	7481	5389	2092
	5 Mitrovica veriore	12326	8879	3447
	6 Skenderaj	50858	35827	15031
	7 Vushtrri	69870	50236	19634
<b>PEJA: 220.338 banorë</b> (160.986, me14+vjeç dhe 59.352 nën 14 vjeç)	1 Pejë	96450	71457	24993
	2 Deçan	40019	29548	10471
	3 Klinë	38496	27098	11398
	4 Istog	39289	28480	10809
	5 Junik	6084	4403	1681
<b>GJAKOVA: 205.377 banorë</b> (145.156 me14+vjeç dhe 60.221 nën 14 vjeç)	1 Gjakovë	94556	69256	25300
	2 Rahovec	56208	40127	16081
	3 Malishevë	54613	35773	18840
<b>GJILANI: 188.188 banorë</b> (138.348, me14+vjeç dhe 49.840 nën 14 vjeç)	1 Gjilan	90178	66714	23464
	2 Kamenicë	36085	27185	8900
	3 Ranillug	3866	3211	655
	4 Novobërdë	6729	5086	1643
	5 Viti	46987	32819	14168
	6 Klllokot	2556	1886	670
	7 Partesh	1787	1447	340
<b>FERIZAJ: 185.695 banorë</b> (131.418, me14+vjeç dhe 54.277 nën 14 vjeç)	1 Ferizaj	108610	77044	31566
	2 Kaçanik	33409	23828	9581
	3 Shtime	27324	18743	8581
	4 Shtërpce	6949	5178	1771
	5 Hani i Elezit	9403	6625	2778
<b>Totali:</b>		<b>1780021</b>	<b>1281204</b>	<b>498817</b>

Figura 3

## 2. NDJEKJA PENALE

### 2.1 TË DHËNA PËR PERSONAT E PËRFSHIRË NË RASTET PENALE

Gjatë pesë viteve (2013–2017), prokuroritë themelore dhe prokuroria special kanë pranuar nga subjektet <sup>3</sup>parashtruese 10.067, lëndë penale (kallëzime penale dhe Informata PPN), në të cilat kanë qenë të përfshirë **16.902** persona, për veprat penale karakteristike<sup>4</sup>, prej të cilëve 13.129 persona në kallëzimet penale, ndërsa 3.773 persona në Informatat PPN (shih figurën 4).

#	PROKURORIA	Kallëzime penale PP të pranuar 2013-2017	Persona në kallëzimet penale PP, të pranuar 2013-2017	Informata PPN të pranuar 2013-2017	Persona në Informatat PPN, të pranuar 2013-2017	Totali rasteve (PP/PPN),	Totali personave në rastet (PP/PPN)
1	PSRK	228	1.225	257	718	485	1.943
2	PRISHTINË	2.722	4.417	763	1.254	3.485	5.671
3	PRIZREN	1.233	1.884	160	256	1.393	2.140
4	PEJË	716	1.062	475	659	1.191	1.721
5	GJILAN	846	1.290	103	133	949	1.423
6	MITROVICË	851	1.372	97	138	948	1.510
7	FERIZAJ	721	1.217	367	473	1.088	1.690
8	GJAKOVË	434	662	94	142	528	804
	Gjithsej:	7.751	13.129	2.316	3.773	10.067	16.902

Figura 4

Sipas kriter sasior për pesë vite (2013-2017), rezultojnë se Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte përqindjen më të lartë të personave të përfshirë në kallëzime penale, me 33.64%, ndërsa përqindjen më të ulët Prokuroria Themelore në Gjakovë, me 5.04%. Për më tej, Prokuroria Themelore në Prishtinë rezultojnë me përqindjen më të lartë të personave të përfshirë në Informatat PPN, me 33.24%, ndërsa Prokuroria Themelore në Gjilan me përqindjen më të ulët, me 3.53% (shih figurën 5).




Figura 5

<sup>3</sup> Policia, Agjencioni kundër korrupsionit, Dogana, Eulex, Administrata Tatimore, Inspektoriat policor, Njësia e inteligjencës financiare, Auditorit gjeneral, Autoriteti pyjor, Agjencioni i pronës, Organet e administratës komunale, I dëmtuari, Prokurori me vetiniciativë, Titullari i pronës dhe Qytetari.

<sup>4</sup> Armët, Drogat, Kontrabandimin me migrant, Krimin e organizuar, Korrupsionit, Shpërlarjen e parasë, Trafikimin me njerëz, Krimet ekonomike dhe Nxitjen e urrejtjes.

## 2.2 TË DHËNA PËR VEPRAT PENALE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), 16.902 personave kanë qenë të përfshirë në rastet penale (Kallëzime penale dhe Informata PPN), prej të cilëve, sipas kriterit të llojit të grupit të veprave penale karakteristike rezultojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë personat në rastet penale të **Korrupsionit**, me **42.50%**, ndërsa përqindjen më të ulët personat në rastet penale të veprës penale **Nxitja e urrejtjes**, me, **0.33%** (shih figurën 6).

	PROKURORIA SPECIALE		PTH PRISHTINË		PTH PRIZREN		PTH PEJË		PTH GJILAN		PTH MITROVICË		PTH FERIZAJ		PTH GJAKOVË		TOTALI: PERSONA	
	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	#	%
A	17	22	39	1	53		3		23		5		23	1	9		196	1.16%
DR	62	4	1594	1	749	6	409	73	410	18	536	15	454	12	241	2	4586	27.13%
KM	87	46	145	1	38		9	3	69	2	24	5	29	5	24		487	2.88%
KO	586	59	4											2			651	3.85%
KOR	304	385	1757	1096	551	236	435	408	534	80	363	114	329	221	233	137	7183	42.50%
SHP	112	195			6	2				1		2					318	1.88%
TNJ	15	2	139	4	31	1	46	16	34	12	54	2	68	13	34	2	473	2.80%
E	15	5	738	151	449	11	151	159	219	20	387		306	219	121	1	2952	17.47%
NU	27		1		7		9		1		3		8				56	0.33%
Tot:	1225	718	4417	1254	1884	256	1062	659	1290	133	1372	138	1217	473	662	142	16902	100%

Figura 6

Sipas kriterit sasior, përqindja më e lartë e personave të përfshirë në kallëzime penale, rezultojnë të jetë në vitin **2017**, me 3058 persona apo **23.29%**, e poashtu edhe përqindjen më të lartë të personave të përfshirë në Informatat PPN, me 1044 persona apo **27.67%** (shih figurën 7).

	VITI 2013		VITI 2014		VITI 2015		VITI 2016		VITI 2017		PP	PPN	TOTALI, PERSONA
	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN	PP	PPN			
A	70	23	44		19	1	25		14		172	24	196
DR	613	21	793	30	645	16	990	34	1414	30	4455	131	4586
KM	129	23	118	22	86	15	40	1	52	1	425	62	487
KO	92	4	165	24	156	8	83	15	94	10	590	61	651
KORR	1048	331	1011	372	860	548	849	705	738	721	4506	2677	7183
SHP	36	48	25	33	27	37	7	56	23	26	118	200	318
TNJ	111	13	93	12	67	18	76	4	74	5	421	52	473
E			737	37	525	113	487	165	637	251	2386	566	2952
NU					38		6		12		56	0	56
Totali:	2099	463	2986	530	2423	756	2563	980	3058	1044	13129	3773	16902

Figura 7

Në vitin **2017** rezultojnë të kishin përqindjen më të lartë, prej **24.27%** të personave të përfshirë në rastet penale (kallëzime penale dhe Informata PPN), (shih figurën 8).




Figura 8

## 2.3 PANORAMA E NDJEKJES PENALE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), **Drogat** përbëjnë përqindjen më të lartë të personave të përfshirë në rastet penale (kallëzimet penale dhe Informatat PPN), në rajonin/prokurorinë e **Mitrovicës**, me **36.49%**, ndërsa të në gjitha rajonet/prokuroritë tjera, përqindjen më të lartë e përbëjnë personat e përfshirë në rastet penale të Korrupsionit (*shih figurën 9*).




Figura 9



## 2.4 NDJEKJA PENALE NË DIMENSIONIN KOHOR

Sipas kriterit të veprës penale me më shumti persona të përfshirë në lëndë (*kallëzime penale dhe Informata PPN*), nëpër prokuroritë themelore përgjatë pesë viteve (2013-2017), rezulton se ndryshime esenciale. Gjersa në vitin 2013 të gjitha prokuroritë kishin numrin më të lartë të personave në veprat penale të Korrupsionit, në vitin 2017 rezulton se korrupsioni dhe drogat përbëjnë veprën penale me më së shumti persona të përfshirë, secila në nga tre (3) prokuroritë themelore, ndërsa vetëm prokuroria themelore në Prizren, rezulton të ketë Krimet ekonomike si veprën penale, me më shumti persona të përfshirë (*shih figurën 10*).




Figura 10

## 2.5 PROFILI I TË DYSHUARVE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), 16.902 persona kanë qenë të përfshirë në Kallëzime penale dhe informata PPN, për veprat penale karakteristike, që në raport me numrin prej 1.281.204 banorëve të përgjegjshëm penalisht, rezultojnë me mesataren e pjesëmarrjes së një personi (të *dyshuari*), në çdo 75 banorë penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç), në nivel vendi (*shih figurën 11*).

RAJONI	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14 + vjeç)	Numri i personave (dyshuarve) të përfshirë për veprat penale karakteristike: 2013-2017	Përqindja e të dyshuarve në raport me numrin e banorëve (14+vjeç)	Raporti në mes një të dyshuari dhe numrit mesatar të banorëve të përgjegjshëm penalisht
<b>PSRK<sup>5</sup></b>	<b>1.281.204</b>	<b>1943</b>	<b>0.151%</b>	<b>659</b>
PRISHTINË	338.804	5671	1.673%	<b>59</b>
PRIZREN	199.915	2140	1.070%	<b>93</b>
MITROVICË	166.577	1510	0.906%	<b>110</b>
PEJË	160.986	1721	1.069%	<b>93</b>
GJAKOVË	145.156	804	0.553%	<b>180</b>
GJILAN	138.348	1423	1.028%	<b>97</b>
FERIZAJ	131.418	1690	1.286%	<b>77</b>
Gjithsej:	<b>1.281.204</b>	<b>16.902</b>	<b>1.32%</b>	Një i dyshuar në 75 banorë

Figura 11

Sipas kriterit të mesatares: pjesëmarrjes së një të dyshuari në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), nivelin më të lartë rezultojnë të ketë rajoni i Prishtinës, me një (1) person të dyshuar në çdo pesëdhjetë e nëntë (59) banorë, ndërsa nivelin më të ulët rajoni i Gjakovës me një (1) person të dyshuar në çdo njëqind e tetëdhjetë (180) banorë (*shih figurën 12*).




Figura 12

<sup>5</sup> Një (1) person në rastet e PSRK-së, mesatarisht në 659 banorë të përgjegjshëm penalisht, në nivel vendi.

### 3. AKUZIMI

#### 3.1 TË DHËNA PËR TË AKUZUARIT

Gjatë pesë viteve (2013-2017), prokuroritë themelore dhe prokuroria speciale kanë ngritur 7176 aktakuza për persona për veprat penale karakteristike. Numri më të lartë të aktakuzave është ngritur për veprat penale të Drogave, me 3024 raste për persona apo 42.14%. Sipas kriterit të vitit, rezulton se në vitin 2017 janë ngritur më shumë aktakuza (2014), ndërsa në vitin 2013 ka qenë niveli më i ulët i ngritjes së aktakuzave (928), (*shih figurën 13*).

VEPRA PENALE	AKTAKUZAT	2013	2014	2015	2016	2017	Totali:	%
ARMËT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor							129 persona, apo 1.80%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë	10	4	4	2	3	23	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	25	40	19	7	15	106	
DROGAT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor	14	80	62	68	180	404	3024 persona, apo 42.14%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë	77	122	212	238	577	1226	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	267	301	235	248	343	1394	
KONTRABANDA ME MIGRANT	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor							300 persona, apo 4.18%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë			2	3		5	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	85	72	71	40	27	295	
KRIMI I ORGANIZUAR	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor							298 persona, apo 4.15%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë							
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve		73	46	122	57	298	
KORRUPSIONI	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor	41	9	15	8	2	75	2010 persona, apo 28.01%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë	53	83	42	26	33	237	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	218	379	386	392	323	1698	
SHIPËRLARJA E PARASË	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor							32 persona, apo 0.45%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë	1					1	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	1	18	6	3	3	31	
TRAFIKIMI ME NJERËZ	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor							325 persona, apo 4.53%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë	3					3	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve	133	38	53	48	50	322	
KRIMET EKONOMIKE	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor		8	2	11	14	35	1017 persona, apo 14.17%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë		115	85	79	83	362	
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve		84	72	166	298	620	
NXITJA URREJTJES	Aktakuzë për dhënien e urdhrit ndëshkimor			18	2		20	41 persona, apo 0.57%
	Aktakuzë e Drejtëdrejtë							
	Aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve			7	8	6	21	
Totali:		928	1426	1337	1471	2014	7176	100%

Figura 13

### 3.2 PROFILI I TË AKUZUARËVE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), prokuroritë kanë ngritur 7.176 aktakuza për persona, të përfshirë në veprat penale karakteristike, prej të cilave numrin më të lartë rezultojnë të ketë prokuroria themelore në Prishtinë, me 1949 aktakuza për persona. Sipas kriterit të veprës penale rezultojnë se numri më i lartë i aktakuzave të ngritura për persona i adresohen veprës penale të Drogave, me 3024 aktakuza për persona apo 42.14% (shih figurën 14).

PROKURORIA	A	DR	KM	KO	KORR	SHP	TNJ	E	NU	#
1 SPECIALE	26	45	94	283	243	32	28	8	22	781
2 PRISHTINË	24	805	83		619		141	274	3	1949
3 PRIZREN	39	580	29	13	266		19	179	5	1130
4 PEJË	1	322	5		140		11	71	3	553
5 GJILAN	16	366	51		235		22	139		829
6 MITROVICË		387	5		191		22	141		746
7 FERIZAJ	19	344	19	2	193		63	146	7	793
8 GJAKOVË	4	175	14		123		19	59	1	395
#	129	3024	300	298	2010	32	325	1017	41	7176

Figura 14

Gjatë pesë viteve (2013-2017), prokuroritë kanë ngritur 7.176 aktakuza për persona për veprat penale karakteristike, që në raport me numrin prej 1.281.204 banorëve të përgjegjshëm penalisht në nivel vendi, rezultojnë me mesataren e pjesëmarrjes së një (1) të akuzuari në çdo 178 banorë (shih figurën 15).

RAJONI	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14 + vjeç)	Numri i personave të akuzuar për veprat penale karakteristike: 2013-2017	Përqindja e të akuzuarve në raport me numrin e banorëve (14+vjeç)	Raporti në mes një të akuzuari dhe numrit mesatar të banorëve të përgjegjshëm penalisht
PSRK <sup>6</sup>	1.281.204	781	0.06%	1 në 1640 banorë
PRISHTINË	338.804	1949	0.58%	173
PRIZREN	199.915	1130	0.57%	176
MITROVICË	166.577	553	0.33%	301
PEJË	160.986	829	0.51%	194
GJAKOVË	145.156	746	0.51%	194
GJILAN	138.348	793	0.57%	174
FERIZAJ	131.418	395	0.30%	332
Gjithsej:	1.281.204	7176	0.56%	1 në 178 banorë

Figura 15

Sipas kriterit të pjesëmarrjes, nivelin më të lartë të dënuarve në raport me numbin e banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), rezultojnë të ketë rajoni i Prishtinës, me raportin me një (1) person të dënuar në njëqind e shtatëdhjetë e tre (173) banorë, ndërsa nivelin më të ulët rajoni i Ferizajit me një (1) të dënuar në trenjëqind e tridhjetë e tre (332) banorë (shih figurën 16).




Figura 16

<sup>6</sup> Në rastet e PSRK-së, një i dënuar në 1640 banorë të përgjegjshëm penalisht, në nivel vendi.

### 3.3 PANORAMA E AKUZIMEVE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), Prokuroritë Themelore kanë ngritur aktakuza për 6395 të dyshuar për veprat penale karakteristike, ndërsa Prokuroria special ka ngritur aktakuza për 781 të dyshuar<sup>7</sup>. Në të gjitha prokuroritë themelore rezulton se vepra penale e **Drogave** përbën numrin më të lartë të personave të akuzuar (shih figurën 17).




Figura 17

<sup>7</sup> Për shkak të kompetencës territoriale të akuzuarit nga prokuroria special nuk përshihen në figurën nr.9.

## 2.4 AKUZIMI NË DIMENSIONIN KOHOR

Numrin më të lartë të personave të akuzuar përgjatë pesë (5) viteve, e përbëjnë veprat penale të Drogave dhe Korrupsionit. Gjersa në vitin 2013, në tre (3) rajone numrin më të lartë e përbënin rastet e personave të akuzuar për korrupsion, në vitin në vazhdim ky numër është zvogëluar për nga një rajon për çdo vit, dhe në vitin 2017 rezulton se në të gjitha rajonet numrin më të lartë të personave të akuzuar e përbën vepra penale e Drogave (shih figurën 16).




Figura 16

## 4. DËNIMI

### 4.1 TË DHËNA PËR VENDIMET GJYQËSORE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), gjykatat kanë marrë **2.067** vendime ndaj të akuzuarve në aktet akuzuese të prokurorive themelore dhe prokurorisë speciale. Nga tërësia e vendimeve të gjykatave rezulton se vendimet me të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor përbën nivelin më të lartë, me 1570 vendime apo **79.96%**, nga tërësia e vendimeve (*shih figurën 18*).

VEPRAT PENALE	Aktakuza është HUDHUR, para shqyrtimit gjyqësor	I akuzuari është shpallur FAJTOR	I akuzuari është LIRUAR	Për të akuzuarin është REFUZUAR Aktakuza	TOTALI:
ARMËT	1	33	4		38
DROGAT	15	819	19	19	872
KONTRABANDA ME MIGRANT	2	78	4	1	85
KRIMI ORGANIZUAR	11	6		2	19
KORRUPSIONI	65	397	177	105	744
SHPËRLARJA PARASË		2		2	4
TRAFIKIMI ME NJERËZ	2	76	7	2	87
KRIMET EKONOMIKE	20	153	12	26	211
NXITJA URREJTJES		6	1		7
	<b>116</b>	<b>1570</b>	<b>224</b>	<b>157</b>	<b>2067</b>

Figura 18

Sipas kriterit të veprës penale, rezulton se nga 1570 vendimet me të cilat Gjykatat kanë shpallur të akuzuarit fajtor gjatë pesë viteve (2013-2017), numri më i lartë i adresohet veprave penale të Drogave, me **819** të akuzuar të shpallur fajtor, apo **52.17%** (*shih figurën 19*).




Figura 19

## 4.2 TË DHËNA PËR VEPRAT PENALE

Sipas kriterit të kompetencës territoriale, rezulton se gjatë pesë viteve (2013-2017), numri më të lartë i të akuzuarve të shpallur fajtor nga gjykata për veprat penale karakteristike i adresohet rajonit të Prizrenit, me 399 të dënuar apo **25.41%**, nga tërësia e të akuzuarve të dënuar me vendime të gjykatës (shih figurën 20).

#	GJYKATA THEMELORE /RAJONI	Armët	Drogat	Kontrabanda me migrant	Krimi organizuar	Korrupsioni	Shpërlarja parasë	Trafikimi me njerëz	Krime ekonomike	Nxitja urrejtjes	Gjithsej:
	<i>Rastet e PSRK<sup>8</sup></i>	1	7	10	6	12	2	3	4	0	45
1	PRISHTINË	2	69	15	0	99	0	11	18	0	214
2	PRIZREN	16	244	18	0	79	0	13	29	0	399
3	PEJË	3	130	2	0	63	0	6	7	0	211
4	GJILAN	3	64	16	0	19	0	7	17	0	126
5	MITROVICË	0	64	0	0	26	0	1	3	0	94
6	FERIZAJ	5	160	12	0	73	0	29	50	6	335
7	GJAKOVË	3	81	5	0	26	0	6	25	0	146
	Gjithsej:	33	819	78	6	397	2	76	153	6	1570

Figura 20

Sipas kriterit të veprës penale me numrin më të lartë të të dënuarve me vendim të gjykatës gjatë pesë viteve (2013-2017), rezulton se vepra penale e Drogave, të ketë nivelin më të lartë të personave të dënuar në gjashtë (6) rajone, ndërsa rajoni i Prishtinës rezulton të ketë Korrupsionin si veprën penale me numrin më të lartë të të dënuarve me vendim të gjykatës (shih figurën 21).



Figura 21

<sup>8</sup> Rastet e personave në lëndët e prokurorisë speciale, nuk janë përfshirë në këtë përlllogaritje për shkak të kompetencës territoriale së saj në tërë territorin e Republikës së Kosovës.



#### 4.3 PROFILI I TË DËNUARVE

Gjatë pesë viteve (2013-2017), gjykatat kanë shpallur fajtor 1570 të dyshuar për veprat penale karakteristike, që në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm (14+vjeç) në nivel vendi, rezulton me mesataren në pjesëmarrje, të një (1) të dënuari në çdo 816 banorë, të përgjegjshëm penalisht në nivel vendi (*shih figurën 22*).

RAJONI	Numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm (14 + vjeç)	Numri i të dënuarve gjatë: 2013-2017	Përqindja e të dënuarve në raport me numrin e banorëve (14+vjeç)	Raporti në mes një të dënuari dhe numrit mesatar të banorëve të përgjegjshëm penalisht
<b>PSRK<sup>9</sup></b>	<b>1.281.204</b>	<b>45</b>	<b>0.004%</b>	<b>28.471</b>
PRISHTINË	338.804	214	0.06%	<b>1583</b>
PRIZREN	199.915	399	0.20%	<b>501</b>
MITROVICË	166.577	211	0.13%	<b>789</b>
PEJË	160.986	126	0.08%	<b>1277</b>
GJAKOVË	145.156	94	0.06%	<b>1544</b>
GJILAN	138.348	335	0.24%	<b>412</b>
FERIZAJ	131.418	146	0.11%	<b>900</b>
Gjithsej:	<b>1.281.204</b>	<b>1570</b>	<b>0.12%</b>	Një i dënuar në <b>816</b> banorë

Figura 22

Sipas kriterit të pjesëmarrjes së një (1) të dënuari në raport me numrin mesatar të banorëve të përgjegjshëm penalisht (14+vjeç), sipas rajoneve, nivelin më të lartë rezulton të ketë rajoni i Gjilanit, me pjesëmarrje të një (1) të dënuari në çdo katërqind e dymbëdhjetë (412) banorë të përgjegjshëm në rajonin e Gjilanit, ndërsa nivelin më të ulët të pjesëmarrjes rezulton të ketë rajoni i Prishtinës rajoni i Gjakovës me pjesëmarrje të një (1) të dënuari në çdo njëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre (1583) banorë të përgjegjshëm penalisht në rajonin e Prishtinës (*shih figurën 23*).




Figura 23

<sup>9</sup> Një (1) person i dënuar në rastet e PSRK-së, mesatarisht në 28.471 banorë të përgjegjshëm penalisht, në nivel vendi.

## 2.4 DËNIMET NË DIMENSIONIN KOHOR

Nga të dhënat e regjistruara në mekanizmin përcjellës ndërinstitucional, rezulton se gjatë pesë viteve (2013-2017), në shumicën e rajoneve, numri më i lartë i të dënuarve i adresohet veprës penale të Drogave, ndërsa në disa rajone nivelin më të lartë rezultojnë të kenë veprat penale të Korrupsionit (*shih figurën 16*).




Figura 16

## KONSTATIME

- Nga numri i përgjithshëm prej 1.780.021 banorëve resident në Republikë, 1.281.204 banorë apo 71.97% janë penalisht të përgjegjshëm (14 vjeç e mbi), ndërsa 498.817 banorë apo 28.02% janë penalisht të papërgjegjshëm (deri në 14 vjeç);
- Në rajonin e Prishtinës jetojnë 26.44% të banorëve të përgjegjshëm penalisht nga tërësia e banorëve resident të përgjegjshëm penalisht në nivel të Republikës, në Prizren 15.60%, në Mitrovicë 13.00%, në Pejë 12.56%, në Gjakovë 11.32%, në Gjilan 10.79% dhe në Ferizaj 10.25%;
- Përqindjen më të lartë të personave të përfshirë në veprat penale karakteristike gjatë pesë viteve (2013-2017), sipas kriterit të rajonit, rezultojnë të ketë Prokuroria Themelore në Prishtinë me 33.55%, duke vazhduar me PTh.Prizren me 12.66%, PTh. Pejë me 10.18%, PTh.Ferizaj me 9.99%, PTh. Mitrovicë me 8.93%, PTh. Gjilan me 8.41%, ndërsa nivelin më të ulët të personave të përfshirë në këto vepra rezultojnë të ketë PTh. Gjakovë me 4.75%. Nga tërësia prej 16.902 personave të përfshirë në veprat penale karakteristike gjatë këtyre pesë viteve, 1.943 persona apo 11.49%, janë trajtuar nga prokuroria speciale.
- Sipas kriterit sasior, të personave të përfshirë në veprat penale (2013-2017), përqindjen më të lartë rezultojnë të ketë Korrupsioni me 42.49%, Drogat me 27.13%, Krimet ekonomike me 17.46%, Krimi organizuar me 3.85%, Kontrabanda me migrantë me 2.88%, Trafikim me njerëz me 2.79%, Shpërlarja e parasë me 1.88%, Armët me 1.15% dhe Nxitja urrejtjes me 0.33%;
- Sipas kriterit vjetor, të personave të përfshirë në veprat penale karakteristike, nivelin më të lartë të personave rezultojnë të ketë në vitin 2017 me 24.27%, në vitin 2016 me 20.96%, në vitin 2014 me 20.80%, në vitin 2015 me 18.81% dhe në vitin 2013 me 15.16%;
- Në gjashtë (6) rajone (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Ferizaj), Korrupsioni përbën veprën penale në të cilën përgjatë pesë viteve (2013-2017), janë përfshirë numri më i lartë i personave, ndërsa në rajonin e Mitrovicës numrin më të lartë të personave të përfshirë gjatë pesë viteve, e përbën vepra penale e Drogave.
- Në vitin 2013 në të gjitha shtatë (7) rajonet (prokuroritë), korrupsioni përbënte nivelin më të lartë të personave të përfshirë në veprat penale karakteristike. Në vitin 2014 Drogat përbënin nivelin më të lartë në: Gjakovë, Prizren dhe Ferizaj; Korrupsioni në Pejë dhe Prishtinë, Krimet ekonomike në Mitrovicë, ndërsa në Gjilan Drogat dhe Korrupsioni. Në vitin 2015 Korrupsioni përbënte nivelin më të lartë në Prishtinë, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë, Krimet ekonomike në Mitrovicë dhe Ferizaj, ndërsa Drogat në Prizren. Në vitin 2016 Drogat përbënin nivelin më të lartë në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren

dhe Ferizaj, Korrupsioni në Gjilan ndërsa Krimet ekonomike në Gjakovë. Në vitin 2017 Korrupsioni në Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë; Drogat në Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë, ndërsa në Ferizaj Drogat dhe Krimet ekonomike;

- Gjatë pesë viteve (2013-2017), 16.902 persona janë përfshirë në veprat penale karakteristike, që në raport me 1.281.204 banorë të përgjegjshëm penalisht rezulton se në nivel të Republikës, një person në çdo 75 banorë të përgjegjshëm ka qenë i përfshirë në ndonjëren prej veprave penale karakteristike. Për më tej, në rajonin e Prishtinës një person në çdo 59 banorë të përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në ndonjëren prej veprave penale gjatë pesë viteve (2013-2017); në rajonin e Ferizajit një person në çdo 77 banorë, në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit një person në çdo 93 banorë, në rajonin e Gjilanit një person në çdo 97 banorë, në rajonin e Mitrovicës një person në çdo 110 banorë dhe në rajonin e Gjakovës një person në çdo 180 banorë;
- Gjatë pesë viteve (2013-2017), prokuroritë kanë ngritur 7.176 aktakuza ndaj personave për veprat penale karakteristike, prej të cilave prokuroria speciale e cila sipas kompetencës territoriale në gjithë territorin e Republikës ka ngritur 781 aktakuza ndaj personave. Prokuroritë themelore gjatë këtyre pesë viteve kanë ngritur 6.395 aktakuza ndaj personave për veprat penale karakteristike. Nga të tërësia prej 6.395 aktakuzave të ngritura, PTh. Prishtinë ka ngritur 30.47%; PTh. Prizren 17.67%; PTh. Gjilan 12.96%; PTh. Ferizaj 12.40%; PTh. Mitrovicë 11.66%; PTh. Pejë 8.64% dhe PTh. Gjakovë 6.17%;
- Gjatë pesë viteve (2013-2017), Prokuroritë kanë ngritur 7.176 aktakuza ndaj personave për veprat penale karakteristike, që në raport me 1.281.204 banorë të përgjegjshëm penalisht rezulton se në nivel të Republikës, një person në çdo 178 banorë të përgjegjshëm ka qenë i akuzuar për ndonjëren prej veprave penale karakteristike. Për më tej, në rajonin e Prishtinës një i akuzuar në çdo 173 banorë të përgjegjshëm penalisht ka qenë i akuzuar për ndonjëren prej veprave penale karakteristike, në rajonin e Gjilanit një i akuzuar në çdo 174 banorë; në rajonin e Prizrenit një i akuzuar në çdo 176 banorë; në rajonin e Pejës dhe Gjakovës një i akuzuar në çdo 194 banorë; në rajonin e Mitrovicës një i akuzuar në çdo 301 banorë dhe në rajonin e Ferizajit një i akuzuar në çdo 332 banorë të përgjegjshëm penalisht;
- Nivelin më të lartë të aktakuzave të ngritura për persona, për pesë vite (2013-2017), në të gjitha prokuroritë themelore e përbën vepra penale e Drogave. Ndërsa sipas viteve, në vitin 2013 nivelin më të lartë të aktakuzave për Droga rezulton të kenë prokuroritë themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren, ndërsa nivelin më të lartë të aktakuzave për Korrupsion rezulton të kenë prokuroritë themelore në Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj. Në vitin 2014, Drogat rezulton të kenë nivelin më të lartë të aktakuzave në Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan, ndërsa Korrupsioni në Prishtinë dhe Gjakovë. Në vitin 2015, Drogat rezulton të kenë nivelin më të lartë të aktakuzave në

Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj, ndërsa Korrupsioni në Gjilan dhe Gjakovë. Në vitin 2016, Korrupsioni rezulton të kenë nivelin më të lartë të aktakuzave në Prishtinë, ndërsa në të gjitha prokuroritë tjera Drogat. Në vitin 2017, në të gjitha prokuroritë nivelin më të lartë të aktakuzave rezultojnë të kenë veprat penale të Drogave.

- Gjatë pesë viteve (2013-2017), gjykatat themelore kanë shpallur fajtor 1.570 të akuzuar për veprat penale karakteristike. Sipas llojit të veprës penale rezulton se 52.16% të akuzuarve janë shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Drogave; 25.28% për Korrupsion, 9.74% për Krime ekonomike, 4.96% për Kontrabandim me migrant, 4.84% për Trafikim me njerëz, 2.10% për Armë, 0.38% për Krim të organizuar, 0.38% për Nxitje të urrejtjes dhe 0.12% për Shpërlarje të parasë;
- Për pesë vite (2013-2017), nga tërësia prej 1570 të akuzuarve të shpalur fajtor, gjykatat themelore kanë shpallur fajtor 45 të akuzuar nga Prokuroria speciale. Ndërsa 1525 të akuzuar të shpalur fajtor sipas gjykatave rezulton të jetë, si në vazhdim: Gj.Th.Prizren ka shpallur fajtor 26.16% të akuzuarve, Gj.Th.Ferizaj 21.96%, Gj.Th.Prishtinë 14.03%, Gj.Th. Pejë 13.83%, Gj.Th.Gjakovë 9.57%, Gj.Th.Gjilan 8.26% dhe Gj.Th. Mitrovicë 6.16%;
- Sipas llojit të veprës penale, rezulton se rajoni i Prishtinës ka nivelin më të lartë të të akuzuarve të shpallur fajtor për Korrupsion ndërsa në të gjitha rajonet tjera niveli më i lartë i të akuzuarve të shpallur fajtor i adresohet Drogave. Ndërsa sipas viteve, nivelin më të lartë të të akuzuarve të shpallur fajtor në të gjitha rajonet në vitin 2013 rezulton të ketë vepra penale e Drogave, në vitin 2014 Gjakova rezulton të ketë Korrupsionin ndërsa gjitha rajonet tjera Drogat, në vitin 2015 Korrupsioni në rajonin e Prishtinës, Mitrovicës dhe Pejës, ndërsa Drogat në rajonin e Gjilanit, Ferizajit, Prizrenit dhe Gjakovës. Në vitin 2016 dhe 2017 rajoni Prishtinës rezulton të ketë Korrupsionin ndërsa të gjitha rajonet tjera rezulton të kenë nivelin më të lartë të dënuarve për veprën penale të Drogave;
- Gjatë pesë viteve (2013-2017), Gjykatat themelore kanë shpallur fajtor 1570 të akuzuar për veprat penale karakteristike, që në raport me 1.281.204 banorë të përgjegjshëm penalisht rezulton se në nivel të Republikës, një person në çdo 816 banorë të përgjegjshëm shpallur fajtor për ndonjëren prej veprave penale karakteristike. Për më tej, në rajonin e Gjilanit një në çdo 412 banorë të përgjegjshëm penalisht në rajonin e Gjilanit është shpallur fajtor, në rajonin e Prizrenit një dënuar në çdo 501 banorë; në rajonin e Mitrovicë një i dënuar në çdo 789 banorë; në rajonin e Ferizajit një i dënuar në çdo 900 banorë, në rajonin e Pejës një i dënuar në çdo 1277 banorë, në rajonin e Gjakovës një i dënuar në çdo 1544 banorë, në rajonin e Prishtinës një i dënuar në çdo 1583 banorë. Ndërsa të akuzuarit nga prokuroria speciale rezulton me një të dënuar në çdo 28.471 banorë të përgjegjshëm penalisht në nivel të Republikës;

## REKOMANDIME:

1. Përlllogaritja e numrit të nevojshëm të prokurorëve nëpër prokuroritë themelore të bëhet në bazë të kriterit të ngarkesës me lëndë, sasisë së lëndëve të reja dhe në bazë të numrit të banorëve në rajon, duke mos përjashtuar edhe kritere tjera që ndihmojnë në përcaktimin e numrit të prokurorëve të nevojshëm në çdo prokurori themelore;
2. Në kuadër realizimit të politikës kriminale, të bëhet profilizimi i prokurorëve në të gjitha prokuroritë themelore dhe prokurorinë speciale. **Shembull:** Një prokuror të ketë profilizim parësor veprat penale të Drogat, profilizimit dytësor veprat penale të Armëve dhe profilizim tretësor veprat penale të vjedhjeve. Prokurori me profilizim parësor për lëndët e Drogave do të trajtoj të gjitha lëndët e Drogave në prokurorinë respektive dhe në varësi të ngarkesës me lëndët e drogave të trajtojë edhe lëndët nga profilizimi dytësor dhe tretësor;
3. Në çdo prokurori themelore të profilizohet nga një prokuror për procesin e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, i cili do të shërbejë si koordinator për këshillimin e prokurorëve të prokurorisë përkatëse, si dhe për raportimin e të dhënave për ngrirje, sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Do të ishte e preferueshme që prokurori me profilizim parësor dhe dytësor të Korrupsionit apo Krimeve ekonomike të ketë si profilizim tretësor çështjen e ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit.
4. Prokurorët të cilët i trajtojnë lëndët e veprave penale karakteristike të përfaqësojnë akuzën në gjykatë, pra rastin të mos e përfaqësojë ndonjë prokurorë tjetër;
5. Rastet e veprave penale karakteristike të cilat pranohen nëpër prokurori, e të cilat i plotësojnë kriteret e kallëzimit penal të mos regjistrohen në regjistrin PPN (*Padi penale të ndryshme*), por në regjistrin PP (*Padi penale*);
6. Kryeprokurorët e prokurorive, të mbajnë shënim dhe të evidentojnë (*në regjitra të krijuar enkas për vlerësimin e performances individuale*), dhe të kërkojnë llogari nga prokurorët, aktakuzat e të cilëve hudhen nga gjykata para shqyrtimi gjyqësor, refuzohen nga gjykata apo të akuzuarit lirohen. Rëndësi të veçantë t'i kushtohet veprave penale të Korrupsionit, të cilat kanë nivel të lartë të hudhjes së aktakuzës para shqyrtimit gjyqësor dhe refuzim të aktakuzës;
7. Meqenëse 52.16% e të dënuarve nga gjykata e shkallës së parë, janë kryes të veprës penale të Drogave, në raport me veprat penale karakteristike, është e nevojshme hartimi i dhe zbatimi i një politike kriminale shumë dimensionale për trajtimin e kësaj dukurije të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi dhe për rininë në veçanti, në të cilën vetëdijësimi dhe parandalimi duhet të jenë aktivitete parësore.

Gjatë pesë viteve (2013-2017), institucionet shtetërore të zbatimit të ligjit kanë proceduar nëpër prokurori 2157 Informata PPN dhe 3398 persona. Ndërsa, qytetarë kanë proceduar 47 Informata PPN me 146 persona dhe të dëmtuarit kanë proceduar 112 Informata PPN me 229 persona.

Lënda PPN nënkupton Padi Penale të Ndryshme, në të cilën mungojnë informatat e nevojshme sigurimi i të cilave do të klasifikonte lëndën në Padi Penale (PP).

Në anën tjetër, data baza KRIM/KORR, është e konfiguruar në atë mënyrë që pa sigurimin e të gjitha të dhënave të lëndës, e njëjta nuk mund të regjistrohet në regjistrin PPN, andaj na lë të kuptojmë se meqenëse lëndët PPN I kanë të gjitha informatat e nevojshme për t'u regjistruar në regjistrin PPN, të njëjtat nuk duhet të regjistrohen në regjistrin PPN por në regjistrin PP (kallëzime penale).